

eppc kërkon një Drejtor Marke për klientin e saj i cili është biznes i konsoliduar dhe me një pozicion të qëndrueshëm në tregun Shqiptar. Biznesi ushtron prej më shumë se 15 vitesh aktivitetin në fushën e tregtisë me shumicë të artikujve ushqimorë duke përfaqësuar 104 marka të ndryshme për të cilat gëzon ekskluzivitetin e tregtimit në Shqipëri dhe në Ballkan.

Ky pozicion ka të bëjë me planifikimin, ekzekutimin dhe monitorimin e aktiviteteve për zhvillimin e biznesit të markave përkatëse. Kërkohet planifikimi dhe menaxhimi i buxheteve dhe burimeve njerëzore për zhvillimin e markave, hartimi dhe zbatimi i strategjive të marketingut si dhe analiza e produkteve për sa i përket çmimeve dhe ecurisë në treg. Pritet gjithashtu konceptimi dhe zbatimi i eventeve dhe aktiviteteve të tjera promovuese.

### KËRKESAT PËR KËTË POZICION JANË:

- Arsimi i lartë. Preferohen drejtime si Marketing, Menaxhim dhe Ekonomiks.
- Diploma të niveleve master ose specializime të ndryshme përbëjnë avantazh.
- Zotërimi i gjuhës Angleze është avantazh.
- Eksperiencë në punë të mëparshme që ka lidhje me këtë pozicion.
- Aftësi të mira në përdorimin e programeve Excel dhe PowerPoint
- Dëshirë për zhvillim, energji dhe aftësi komunikuese shumë të mira.
- Aftësi në drejtim dhe organizim.
- Aftësi analitike dhe prezantuese.

### Të dhënat

<b>Pozicioni:</b>	Drejtor Marke
<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë
<b>Orari:</b>	40 ore pune në javë
<b>Vartës direkt:</b>	Jo
<b>Raporton tek:</b>	Drejtori i Shitjeve
<b>Udhëtime pune:</b>	Po. Kryesisht në Shqipëri.
<b>Pagesa:</b>	Pagë bazë + bonus në varësi të performancës
<b>Kontrata:</b>	Sipas Kodit të Punës
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	15.07.2011

### Si të aplikoni

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur pozicionin për të cilin aplikoni tek:

[info@eppc.al](mailto:info@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.